Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup

Email: [alihoxha1976@hotmail.com](mailto:alihoxha1976@hotmail.com)

### **Abstrakt**

Të gjitha organizatat euro-atlantike, në këtë rast NATO dhe BE, vazhdimisht promovojnë politikën e dyerve të hapura dhe zgjerimit, por kushtet të cilat ato kanë vënë për anëtarësim të shteteve të reja janë shumë të përpikta dhe përfshijnë shumë aspekte. Një nga qëllimet e rëndësishme e Republikës së Maqedonisë së Veriut është anëtarësimi në NATO dhe BE. NATO është aleanca ushtarako-politike më e suksesshme në historinë e civilizimit njerëzor. Më 27 mars 2020 Republika e Maqedonisë së Veriut u bë vend anëtarë i 30-të i NATO-s.

BE (Bashkimi Evropian) është familje e shteteve demokratike Evropiane që punojnë së bashku për të përmirësuar jetën e qytetarëve të saj dhe për të ndërtuar një botë më të mirë, andaj edhe anëtarësimi i plotë në Bashkimi Evropian paraqet qëllim strategjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Që nga formimi i tyre si NATO dhe BE kanë ndihmuar në ruajtjen dhe forcimin e sigurisë dhe të stabilitetit në Evropën Perëndimore. Temën time e kam titulluar “Tre marrëveshjet ndërkombëtare të Maqedonisë së Veriut si shkak për anëtarësimin në BE” ku me theks të veçantë do të përqendrohem te: Marrëveshja Kornizë e Ohrit, Marrëveshja e Prespës dhe Marrëveshja e fqinjësisë së mirë. Të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare paraqesin ligj për shtetet që janë palë të atyre marrëveshjeve. Në kuadër të së drejtës publike marrëveshjet ndërkombëtare njihen si burime të rëndësishme të së drejtës, sidomos të asaj ndërkombëtare. Secila nga marrëveshjet ndërkombëtare kanë specifikat e veta, natyrisht edhe dallimet e saja.

**Fjalë kyç:** NATO, BE, Marrëveshja Kornizë e Ohrit, Marrëveshja e Prespës, Marrëveshja e Fqinjësisë së Mirë.

## Marrëdhëniet Shqipëri- Kosovë përgjatë viteve 2000

**Dr. Blerina Xhelaj**

Universiteti “ Ismail Qemali” Vlorë

Fakulteti i Shkencave Humane- Departamenti i Edukimit

Email: [blerina.xhelaj@univlora.edu.al](mailto:blerina.xhelaj@univlora.edu.al)

### **Abstrakt**

Marrëdhëniet shqiptaro-kosovare i referohen marrëdhënieve kulturore, shpirtërore që nga e kaluara historike e deri në ditët e sotme. Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, Shqipëria do të kishte ambasadën e saj në Prishtinë dhe Kosova do të çelte ambasadën e saj në Tiranë. Zyrtarisht 92.93% e popullsisë së Kosovës janë shqiptarë dhe shqipja është gjuhë zyrtare në Kosovë. Kosova e shpalli pavarësinë e saj prej Serbisë më 17 shkurt 2008. Ajo ishte vendi i fundit që u shkëput nga federata ish jugosllave. Shqipëria u bë një nga pesë shtetet e para që njohu pavarësinë e Kosovës. Madje nga ana e qeverisë shqiptare e asaj kohe që kryesohej nga kryeministri shqiptar Sali Berisha, u deklarua edhe për një administrim doganor mes dy vendeve “motra”. Kjo deklaratë ngjalli një zemërim në qarqet serbe. Ministria e Jashtme e Shqipërisë, në një shënim sqarimi për Serbinë, deklaroi se Shqipëria e konsideronte shtetin e pavarur të Kosovës si faktor paqeje dhe stabiliteti në rajonin e Ballkanit, ndërsa pavarësia e saj konsiderohet si një hap i qartë që u shërben njerëzve, stabilitetit dhe perspektivës evropiane të rajonit dhe se politika e jashtme e Republikës së Shqipërisë bazohet në objektivat e përbashkëta të integritimit euroatlantik të vendit, Republikës së Kosovës dhe të gjithë rajonit. Në tetor 2011, u arrit një marrëveshje mes Ministrisë së Kulturës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë për përdorimin e përbashkët të ambasadave dhe shërbimeve konsullore. Në maj 2012, një abetare e zakonshme për vitin akademik 2012-2013 e klasës së parë u miratua nga dy qeveritë respektive. Gjithashtu, u hodh idea e parë e një tregu rajonal shqiptar si një risi për një hapësirë të përbashkët ekonomike midis Shqipërisë dhe Kosovës gjatë vitit 2011.

**Fjalë kyç:** rajon, stabilitet, integrim, BE, administrim doganor

## Siguria kibernetike në Shqipëri

**Dhurata Hoxha**

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: [dhurata.hoxhaj@universitetiaab.com](mailto:dhurata.hoxhaj@universitetiaab.com)

### **Abstrakt**

Çdo ditë e më shumë jetët e qytetarëve po bëhen më të lehta me ndihmën e teknologjisë e cila po avancohet dita e ditës por gjithashtu kjo e mirë e ka edhe një të keqe. Sulmet që bëhen nëpër rrjetet e sigurisë po bëhen të papritura dhe të shpeshta, sikurse që ka ndodhur në Shqipëri vitin që lamë pas saktësisht me 15 korrik 2023 kanë ndodhur 49 sulme prej 12 nga më të rënda. Këtij rasti i ka ardhur në ndihmë SHBA dhe BE, ku kanë ndihmuar në përforcimin e rrjetit kibernetik me një shumë të konsiderueshme parash. Problemi është zgjidhur brenda afatit dhe sulmi që i është bërë nga ana e Iranit është përmirësuar. Andaj zgjedhja e këtyre problemeve duhet të merret seriozisht për shkak që vihet në rrezik edhe ekonomia e shtetit si dhe jetët e qytetarëve janë në rrezik për shkak të sulmeve në llogaritë bankare, e-sistem etj. Ajo çfarë mësuam rreth këtij problemi rreth sulmeve është se duhet marrë parasysht përforcimi i rrjeteve të Sigurisë Kibernetike andaj ndihma nga shtetet e fuqishme sikur SHBA dhe BE i hyjnë në punë një vendi të vogël sikur që është Shqipëria që i ndihmon në përforcim dhe menaxhim të rrjeteve sidomos Policisë së Shtetit.

**Fjalë kyç:** sulm kibernetik, teknologji, SHBA, BE, Iran.



# Roli i administratës publike në promovimin e paqes dhe zhvillimit të qëndrueshëm: Rasti i Republikës së Kosovës

Elsa Zyberaj

PhD Cand., Universiteti i Evropës Juglindore

Email: [ez31437@seeu.edu.mk](mailto:ez31437@seeu.edu.mk)

## Abstrakt

Administrata publike në Republikën e Kosovës luan rol të rëndësishëm në ndërtimin dhe promovimin e paqes sociale si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Duke qenë balancuese e tillë punimi mëton të hedhë dritë mbi sfidat dhe mundësitë që hasen në këtë proces në veprimtarinë e administratës publike, dhe duke specifikuar përvojat e suksesshme në këtë drejtim. Një vend të veçantë në punim marrin edhe sfidat specifike me të cilat përballen institucionet publike në Republikën e Kosovës ku përfshihet korrupsioni, nepotizmi si dhe mungesa e kapaciteteve të cilat japin ndikim të drejtpërdrejtë në mos qëndrueshmërinë institucionale. Përmes një analize të detajuar të praktikave aktuale evropiane dhe studimeve të rasteve të suksesshme në Kosovë dhe Evropë synohet që të identifikohen pikat kyçe të suksesit dhe të ofrohen rekomandimet për përmirësimin e efikasitetit dhe transparencës në sektorin publik për të arritur në realizimin e një administrate më të drejtë, të qëndrueshme dhe të aftë për të ndërtuar paqe dhe siguri në Kosovë

**Fjalë kyçe:** Administratë publike, Kosova, zhvillim i qëndrueshëm, paqe sociale, reforma.

## Sfidat e parandalimit të kriminalitetit tek të miturit në sistemin penitenciar shqiptar''

**PhD. Esjurda Tallushi**

Universiteti i Tiranës

Email: [esjurda3tallushi@gmail.com](mailto:esjurda3tallushi@gmail.com)

**Prof. Asoc. Dr. Marinela Sota**

Universiteti i Tiranës

Email: [sotamarinela@yahoo.com](mailto:sotamarinela@yahoo.com)

### **Abstrakt**

Legjislacioni ndërkombëtar i jep prioritet jo vetëm integrimit në shoqëri të të miturve në konflikt me ligjin përmes politikave sociale, por sidomos parandalimit të kriminalitetit të të miturit. Në Shqipëri, përveç përfaqësive ndërkombëtare në kuadrin ligjor e në praktikat në interesin më të lartë të të miturve, mbetet sfidë pjesa e parandalimit të kriminalitetit të të miturit. Qëllimi i këtij studimi është evidentimi i sfidave të parandalimit të kriminalitetit të të miturit në sistemin penitenciar shqiptar. Metoda e përdorur e kërkimit është ajo cilësore e bazuar në intervista me pyetje të hapura me të gjithë punonjësit profesionistë të zinxhirit të institucioneve korrektuese, si: Instituti i të Miturve në Konflikt me Ligjin, por edhe institucioneve me fokus komunitar, instancat e pushtetit lokal, me përfaqësues të të Miturve si dhe përfaqësues të OJF-ve që kanë kontribut ndër vite me këtë fokus. Intervistat janë realizuar me 15 subjekte të përzgjedhura përmes kampionimit me qëllim.

Disa nga gjetjet e studimit përsa i përket sfidave në sistemin penitenciar mbi parandalimin e kriminalitetit të të miturit lidhen me: mungesën e kapaciteteve njerëzore në instancat e pushtetit lokal të cilat nuk merren vetëm me të miturit në konflikt me ligjin, por duhet të mbulojnë edhe shumë targete të tjera. Legjislacioni për të mitur nuk është shoqëruar me të gjitha strukturat e mirëfillta të koordinimit me shërbime konkrete; mungesa e bashkëpunimit ndër-institucional; mungesa e mbështetjes së familjeve me politika sociale konkrete etj.

Si përfundim e rëndësishme do të ishte që ndërgjegjësimi në lidhje me veprat penale tek prindërit, por edhe vetë fëmijët të fillojë në çdo shkollë të vendit që në ciklin e lartë të arsimit 9-vjeçar.

**Fjalë kyç:** parandalim, sistem penitenciar, i mitur, sfidë, kriminalitet.

## Kosova - kontribuese për paqen në rajonin e trazuar

**Dr.sc. Fatmir Qollakaj**

Kolegji AAB, Fakulteti Juridik

Email: [fatmir.qollakaj@universitetiaab.com](mailto:fatmir.qollakaj@universitetiaab.com)

### **Abstrakt**

Zhvillimet kohën e fundit në Evropë e posaçërisht që nga agresioni i Rusisë në Ukrainë kanë interferuar në stabilitetin e regjionit, në ç'ekuilibrimin e sigurisë dhe riaktualizimin e fuqizimit të të konceptit mbi sigurinë kolektive. Agresioni i Rusisë në Ukrainë ishte atak direkt në rendin botëror dhe indirekt sfidë shumë serioze për NATO n, SHBA -n dhe miqtë e sajë.

Kosova në këtë vorbull ngjarjesh e zhvillimesh ndoqi një vijë unike e konfirmimit të aleatit natyral me SHBA, mirënjohëse ndaj NATO s dhe u rreshtua përkrah miqve ndërkombëtar duke i vendosur sanksione Rusisë por edhe duke fuqizuar rendin e ligjin, parakushte këto të demokracisë së qëndrueshme sfond i pa kontestuar për një siguri të qëndrueshme në regjion e më gjerë. Në aspektin e ngushtë të sigurisë Republika e Kosovës filloi përpjekjet e suksesshme të konsolidimit dhe fuqizimit të sistemit të Sigurisë parakusht për kontribut në sigurinë regjionale duke zhvilluar me saktësi reformën e FSK sipas planit të paraparë paraprakisht si dhe duke përbushur standardet operative ushtarake për tu anëtarësuar në NATO, objektiv real i synuar. Edhe në përballjen me sfidat serioze të sigurisë si sulmi terrorist, në shtator 2023, sulmet hibride në kontinuitet dhe lufta speciale e orkestruar e koordinuar nga Serbia, Republika e Kosovës ka rezultuar e suksesshme duke iu përmbajtur strikt konceptit konvencional të mbrojtjes së rendit juridik e kushtetues dhe garantimit të sigurisë së të gjithë qytetarëve pa dallim.

Metodologjia e aplikuar në punim përmban metodat: analiza e përmbajtjes, metoda empirike, krahasimore.

**Fjalë kyç:** Siguria, ligji, Republika e Kosovës, siguria kolektive, NATO.

## **Përparësitë e Kosovës në integrimin në struktura euroatlantike pas agresionit të Rusisë në Ukrainë**

**Prof. Ass. Dr. Mentor Lecaj**

Fakulteti Juridik, Kolegji AAB, Prishtinë

Email: [mentor.lecaj@universitetiaab.com](mailto:mentor.lecaj@universitetiaab.com)

### **Abstrakt**

Ky punim fokusohet në gjetjen e faktorëve, të cilët kanë efekt politik dhe që ndikojnë rritjen e mundësisë së përsheptimit të integritit të Kosovës në strukturat euroatlantike, posaçërisht në NATO.

Në këtë artikull janë përdorur metoda deskriptive, komperative dhe analitike me qëllim të provohen mendimet e ndryshme të autorëve, dhe të dhënat në dokumente zyrtare nga institucionet ndërkombëtare, të cilët i janë qasur kësaj problematike.

Në këtë punim shkencor janë gjetur përparësitë dhe anët negative të luftës në Ukrainë sa i përket anëtarësimit të Kosovës në strukturat euroatlantike. Si anë negative konsiderohet, të jete rritja e skepticizmit dhe e kundërshtarëve të pavarësisë së Kosovës, e cila kjo do të pengojë anëtarësimin e Kosovës në organizata të përgjithshme ndërkombëtare p.sh. në Kombet e Bashkuara, ndërsa efekti pozitiv i agresionit rus në Ukraine pritët të jetë rritja e dinamikave të integritit më të shpejt të Kosovës në NATO dhe në organizata ndërkombëtare aty ku ndikimi i vendeve perëndimore nuk varet nga drejta e vetos e vendeve kundërshtare të pavarësisë së Kosovës.

Në këtë punim konkludohet se me ndryshimin e rendit botëror, e me fillimin e agresionit rus në Ukrainë, Ballkani Perëndimor, e në veçanti Kosova do të jetë fokusi i debateve në qarqet vendimmarrëse globale.

Ky artikull shkencor, është i bazuar në mendime pro dhe kundra të autoreve të ndryshëm të, cilët theksojnë se agresioni në Ukrainë nga Rusia ka ndikuar esencialisht në panoramën politike të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

**Fjalë kyç:** Rendi botëror, agresioni rus, Ukraina, Kosova, NATO.

## **Bashkëpunimi mes Kosovës dhe Shqipërisë në periudhën afatmesme në krijimin e kapaciteteve të përbashkëta ushtarake sipas konceptit “smart defence”**

**Remzije Morina**, kolonele në pension

Email: [rashimon9846@gmail.com](mailto:rashimon9846@gmail.com)

### **Abstrakt**

Interesat kombëtare janë gurë themeltarë për formulimin e politikës së sigurisë kombëtare dhe shërbejnë si udhëzime për t’u përballur me kërcënimet e sigurisë dhe për t’i trajtuar mundësitë në dispozicion ndërkohë që qëllimet e sigurisë kombëtare shërbejnë si udhëzime për mbrojtjen dhe avancimin e interesave kombëtare. Bashkëpunimi i mbrojtjes ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, i cili filloi në fillim të viteve 1990, mund të karakterizohet në tre periudha të dallueshme: së pari nga 1991 deri në fund të luftës në Kosovë në qershor 1999; Së dyti nga qershori i vitit 1999 deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës në shkurt 2008; dhe e treta pas pavarësisë, kur bashkëpunimi midis vendeve filloi të funksionojë normalisht.

Fushat në të cilat bashkëpunimi mbrojtës midis Shqipërisë dhe Kosovës është më i zhvilluar janë arsimi dhe trajnimi ushtarak (E & T) dhe integrimi euroatlantik. Ky bashkëpunim duhet të zhvillohet gjerësisht dhe të bëhet me kujdes për të siguruar që të gjitha aktivitetet e tilla të kryhen në një standard të lartë. Në veçanti, fusha të caktuara të dukshmërisë së lartë, siç janë "operacionet", duhet t'u jepet prioritet bashkëpunimit për shkak të përfitimeve reciproke që ato ofrojnë për të ndihmuar në zgjidhjen e situatave të sigurisë që mund të lindin dhe efekti i tyre pozitiv në opinionin publik dhe mbi klimën e përgjithshme të bashkëpunimit dhe sigurisë ndërmjet dy vendeve dhe më gjerë. Format i bashkëpunimit duhet të bazohet në formatin e “*smartdefence*” apo “*poolingandsharing*” të disa kapaciteteve.

**Fjalë kyç:** Shqipëria, Kosova, “smart defence”, “poolingandsharing”

## **Roli i Inteligjencës artificiale në menaxhimin e sigurisë dhe paqes në vendet e Ballkanit Perëndimor, me theks të veçantë në Kosovë**

**Prof. Asoc. Dr. Veton Vula**

Kolegji AAB

Email: [veton.vula@universitetiaab.com](mailto:veton.vula@universitetiaab.com)

**Prof. Ass. Dr. Mensut Ademi**

Email: [mensut.ademi@universitetiaab.com](mailto:mensut.ademi@universitetiaab.com)

Kolegji AAB

**PhD(c) Drizan Shala**

Universiteti i Sarajevës

Email: [drizan.shala@gmail.com](mailto:drizan.shala@gmail.com)

### **Abstrakt**

Siguria dhe paqja janë dy qëllime themelore në një botë të trazuar. Siguria përbën mbrojtjen nga rreziqet dhe kërcënimet, ndërsa paqja është gjendja e marrëdhënieve të qetësisë dhe bashkëpunimit midis njerëzve. Në një situatë të trazuar, këto vlera përbëjnë sfidën për të arritur stabilitetin dhe harmoninë, duke kërkuar përpjekje të përbashkëta për të zbutur konfliktet dhe për të ndërtuar sisteme të qëndrueshme të drejtësisë. Në këtë drejtim, qëllimi i këtij punimi është analizimi i situatave dhe rreziqeve tjera potenciale në rrezikimin e paqes dhe sigurisë nga përdorimi i IA. Lidhur me këtë, shtrohet edhe pyetja kërkimore, sa dhe cili është roli i IA në menaxhimin e sigurisë së shtetit përfshinë strategjitë nacionale dhe veprimet për të mbrojtur dhe ruajtur stabilitetin dhe integritetin e shtetit. Nga punimi dalin disa rekomandime se IA ka një potencial të madh për të menaxhuar sigurinë dhe paqen në Kosovë dhe në vendet e tjera të Ballkanit perëndimor.

**Fjalë kyç:** Inteligjenca artificiale (IA), siguria, paqja, menaxhimi.

## Dezinformimi dhe lufta hibride

Dr.sc. Xhevahire Krasniqi-Podvorica

Fakulteti Administratë Publike-Kolegji AAB

Email: [xhevahire.krasniqi-podvorica@universitetiaab.com](mailto:xhevahire.krasniqi-podvorica@universitetiaab.com)

### Abstrakt

Dezinformimi dhe lufta hibride janë dy procese të cilat gërshetohen njëra me tjetrën dhe janë mjete të cilat e plotësojnë njëra tjetrën. Fundi i viteve tetëdhjeta dhe fillimi i viteve nëntëdhjeta shënojnë një epokë të re në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në sigurinë botërore. Rrënja e sistemit monist në disa vende të Evropës Lindore, posaçërisht shkatërrimi i Bashkimit Sovjetik dhe shpërbërja e ish Jugosllavisë, pastaj edhe zhvillimi i teknologjive të reja, sidomos në sferën e informimit, internetit dhe rrjeteve sociale, ndikuan në krijimin e metodave të reja të paraqitjes së konflikteve, tanimë me mjete moderne. Këto dukuri ndikuan edhe në krijimin e terminologjisë së re, si lufta hibride, dezinformimi, lajmet e rreme etj. Dezinformimi ka për qëllim shtrembërimin e gjendjes faktike dhe krijimin e realiteteve të reja dhe të rrejshme, me qëllim arritjen e efekteve të dëshirueshme. Këto lajme të rrejshme ose dezinformata janë pjesë e luftës hibride e cila kohëve të fundit gjithnjë e më shumë po merr hov. Me denoncimin e këtyre veprimeve devijante në shoqëri, synohet të parandalohen veprimet destruktive të strukturave të ndryshme qeveritare apo paramilitare a kriminale. Për të arritur këtë duhet përdorur metoda të ndryshme të denoncimit si krahasimi, faktimi dhe informimi i drejtë i opinionit. Rezultatet e një veprimi të këtillë do të parandalojnë arritjen e qëllimeve të cilat krijojnë huti dhe konflikte në mjedise të ndryshme, posaçërisht në shoqëritë me demokraci diskutabile të zhvillimit shoqëror.

**Fjalë kyç:** dezinformimi, lufta hibride, siguria ndërkombëtare, internet, lajmet e rreme

## Krimet kundër njerëzimit në shekullin 21, sfida dhe specifika

**Ma. Zara Nebihu Arnaout**

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: [zara.nebihu@universitetiaab.com](mailto:zara.nebihu@universitetiaab.com)

### **Abstrakt**

Gjenocidi është shkatërrimi i qëllimshëm i një populli tërësisht ose pjesërisht. Në vitin 1948, Konventa e Kombeve të Bashkuara për Gjenocidin e përkufizoi gjenocidin si çdo nga pesë aktet e kryera me qëllim për të shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racor ose fetar. Në këtë punim janë analizuar dhe përkujtuar disa nga gjenocidet më të fundit të shekullit të kaluar si ai në Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë, pastaj lufta Rusi-Ukrainë si dhe Gjenocidi aktual i Izraelit ndaj popullit të Gazas, respektivisht të Palestinës. Pyetja kërkimore e këtij studimi ka qenë, *“Cilat janë disa nga shkaqet dhe pasojat e gjenocideve?”* Duke adresuar këtë pyetje, analizat dhe rezultatet e këtij studimi kanë treguar se gjenocidi nuk ka arsye për të ndodhur dhe si i tillë meriton dënimin më të ashpër në përputhje me ligjin si dhe pasojat e gjenocideve gjithmonë kanë qenë fatalitet dhe katastrofë e madhe me humbjen e jetës së qindra mijëra qytetarëve të pafajshëm.

**Fjalë kyç:** Gjenocid, vrasje, llogaridhënie, Kosovë, Gaza, Palestinë, Izrael, Ukrainë



## Qeverisja e Mirë dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm në Rajonet e Konfliktit: Rasti i Kosovës

PhDc. Albulena Brestovci & PhDc. Blinera Veliu

Fakulteti Administratë Publike, Kolegji AAB

Email: [albulena.brestovci@universitetiaab.com](mailto:albulena.brestovci@universitetiaab.com)

Email: [blinera.veliu@universitetiaab.com](mailto:blinera.veliu@universitetiaab.com)

### Abstrakt

Qeverisja e mirë është çështje thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm e veçanërisht në rajonet e prekura nga konflikti ku stabiliteti dhe ndërtimi i paqes janë prioritet. Ky punim do të shqyrtoj ndikimin e praktikave të qeverisjes së mirë në krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm në Republikën e Kosovës, një rajon që ka kaluar një periudhë të gjatë konfliktesh dhe tranzicioni politik. Duke analizuar elementet kryesore të qeverisjes së mirë, si transparenca, llogaridhënia, pjesëmarrja e komunitetit dhe efektiviteti institucional, studimi përpiket të identifikojë praktikatat dhe politikatat që kanë kontribuar në stabilitetin dhe zhvillimin e Kosovës.

Përmes një kombinimi metodash kërkimore, përfshirë analizën e politikave, intervistat me zyrtarë dhe ekspertë të qeverisjes, dhe studimet e rasteve, ky punim eksploron sesi administrata publike e Kosovës ka adresuar sfidat dhe ka promovuar zhvillimin e qëndrueshëm. Rezultatet tregojnë se praktikatat e qeverisjes së mirë kanë ndihmuar në parandalimin dhe menaxhimin e konflikteve, krijimin e një ambienti të qëndrueshëm dhe përmirësimin e besimit publik.

Në fund, punimi sugjeron rekomandime për politikatat publike dhe strategjitë që mund të implementohen nga administratat lokale dhe ndërkombëtare për të promovuar qeverisjen e mirë dhe zhvillimin e qëndrueshëm në rajonet e tjera të prekura nga konflikti. Ky studim kontribuon në literaturën ekzistuese mbi qeverisjen e mirë dhe zhvillimin e qëndrueshëm, duke ofruar njohuri të vlefshme për politikëbërësit, akademikët dhe praktikuesit në fushën e qeverisjes publike dhe zhvillimit ndërkombëtar.

**Fjalë kyç:** qeverisje e mirë, zhvillimi i qëndrueshëm, transparenca, llogaridhënie

## Lidershipi në reformimin e administratës publike: Rasti i Kosovës

**Prof. Ass. Dr. Vrullim Buja**

Fakulteti Administratë Publike, Kolegji AAB

Email: [vrullim.buja@uni-edu.net](mailto:vrullim.buja@uni-edu.net)

### **Abstrakt**

Reformimi i administratës publike është një komponent kyç në përmirësimin e qeverisjes dhe ndërtimin e institucioneve të qëndrueshme dhe transparente, veçanërisht në vendet që kanë kaluar periudha të gjata tranzicioni politik dhe ekonomik. Ky studim shqyrton rolin e lidershipit në procesin e reformimit të administratës publike në Kosovë, duke u fokusuar në strategjitë dhe metodat që janë përdorur për të adresuar sfidat dhe për të arritur qëllimet e reformës. Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, Kosova është përballur me sfida të shumta për të krijuar një administratë publike efektive dhe të besueshme. Udhëheqësit kosovarë kanë zbatuar një sërë strategjish për të përmirësuar funksionimin e administratës, duke përfshirë vizionin dhe planifikimin strategjik, përfshirjen e palëve të interesuara, menaxhimin e ndryshimeve dhe luftën kundër korrupsionit.

Studimi gjithashtu shqyrton rolin e komunitetit ndërkombëtar, veçanërisht të Bashkimit Evropian dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, në mbështetjen e përpjekjeve për reformë përmes asistencës teknike, trajnimeve dhe fondeve. Përmirësimet e arritura në administratën publike të Kosovës tregojnë rëndësinë e lidershipit efektiv dhe të qartë në drejtimin e reformave. Megjithatë, studimi thekson se sfidat mbeten, përfshirë nevojën për të përmirësuar më tej kapacitetet institucionale, për të luftuar korrupsionin dhe për të ruajtur besimin e publikut.

Ky studim ofron një analizë të thelluar të përvojës së Kosovës në reformimin e administratës publike, duke nxjerrë mësimet vlefshme për vendet e tjera që ndodhen në faza të ngjashme të tranzicionit. Rezultatet e këtij studimi synojnë të kontribuojnë në debatin akademik dhe praktik mbi rolin e lidershipit në ndërtimin e administratave publike efektive dhe të qëndrueshme në kontekste post-konfliktuale dhe tranzicionale.

**Fjalë kyç:** Lidershipi, reformimi i administratës publike, Kosova, transparenca, efikasitetet qeverisës.

# Ndikimi i marketingut digjital në mbështetjen për politikat buxhetore dhe informacionin publik në vendet në zhvillim

**Etleva Namligjiu**

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: [etleva.namligjiu@aab-edu.net](mailto:etleva.namligjiu@aab-edu.net)

## **Abstrakt**

Mediat sociale dhe interneti kanë siguruar një platformë alternative për marketingun ndërkombëtar. Këto platforma po ndryshojnë gjithnjë e më shumë tregtinë për mirë, gjithashtu i jep sektorit publik një shans për të ndërtuar marrëdhënie më të forta dhe më kuptimplote me audiencën e tyre. Menaxhimi i marrëdhënieve ndërmjet agjencive qeveritare, publikut të gjerë dhe palëve të tjera që kërkojnë shërbime prej tyre është qëllimi kryesor i marketingut të sektorit publik dhe marketingu digjital e bën këtë më të lehtë. Qëllimi i këtij studimi është të kuptojë se si adoptimi i teknologjisë së marketingut digjital ndikon në ekonominë në zhvillim. Në punim analizohet ndikimi i marketingut digjital në informacionin publik si dhe në mbështetjen për politikat buxhetore në vendet në zhvillim. Ky studim plotëson boshllëqet teorike në literaturë duke kuptuar ndikimin e marketingut digjital në marrëdhënie me publikun. Ky punim konkludon se zgjidhja më e mirë për të rritur mbështetjen për politikat buxhetore dhe informacionin publik për një vend në zhvillim është të zbatojë kombinimin e të dy strategjive, marketingu digjital dhe tradicional. Meqenëse, ka grupe njerëzish që ende lidhen me marketingun tradicional, si televizioni, radio dhe materialet e leximit, ndërkohë që statistkisht, popullata e re priret të kalojë më shumë kohë në internet.

**Fjalë kyç:** marketingu digjital, politikat buxhetore, vendet në zhvillim, marketingu tradicional, shërbime.

## **Roli i edukimit dhe trajnimit në zhvillimin ekonomik - rasti i Kosovës**

**Rrezarta Gashi**

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: [rezarta1.gashi@universitetiaab.com](mailto:rezarta1.gashi@universitetiaab.com)

### **Abstrakt**

Edukimi dhe trajnimi janë elemente thelbësore për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Investimi në këto fusha mund të krijojë një forcë punëtore të kualifikuar, të ulur papunësinë dhe të nxisë inovacionin. Kjo, nga ana tjetër, do të ndihmojë në ndërtimin e një ekonomie të qëndrueshme dhe konkurruese. Ky punim ka për qëllim të eksplorojë rolin dhe ndikimin e edukimit dhe trajnimit në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Përmes një analize të hollësishme të politikave arsimore dhe programeve të trajnimit, studimi synon të zbulojë mënyrat se si investimet në këto fusha mund të kontribuojnë në krijimin e një fuqie punëtore të kualifikuar, uljen e papunësisë dhe nxitjen e inovacionit, duke ndihmuar në ndërtimin e një ekonomie të qëndrueshme dhe konkurruese në Kosovë. Rezultatet tregojnë se investimet në edukim dhe trajnim përmirësojnë ndjeshëm kualifikimet e forcës së punës në Kosovë, duke përgatitur individët për tregun e punës dhe duke ulur papunësinë përmes aftësive dhe njohurive të reja. Këto programe nxisin inovacionin përmes kulturës së mësimi të vazhdueshëm dhe zhvillimit të aftësive teknologjike dhe krijuese. Përmirësimi i infrastrukturës edukative rrisin cilësinë e arsimit dhe ofrojnë më shumë mundësi për të rinjtë në arsim dhe trajnim profesional. Zhvillimi i politikave të fokusuar në edukim dhe trajnim është thelbësor për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërsa bashkëpunimi i shtuar publik-privat ka mundësuar programe të përshtatura me nevojat e tregut të punës, duke lehtësuar tranzicionin nga edukimi në punësim.

**Fjalë kyç:** zhvillimi ekonomik, edukimi, trajnimet, inovacioni, Kosova.

## Zhvillimi dhe zgjidhja e problemit “principal-agjent” më vështrim të veçantë në bizneset e rajonit të Pejës

Fatos Turkaj

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, Prishtinë

Email: [fatosturkaj@gmail.com](mailto:fatosturkaj@gmail.com)

### Abstrakt

Ky punim e shtjellon temën e zhvillimit të problemit “principal-agjent” dhe me mënyrën se si veprohet në bizneset e rajonit të Pejës, për zgjidhjen e këtij problemi. Ky fenomen është prezent tek bizneset, ku është i ndarë menaxhimi nga pronësia, e kjo shoqërohet me humbje të ndryshme, sepse menaxherët nuk kanë motive të mëdha për arritjen e fitimit maksimal, sikurse kanë pronarët e bizneseve. Menaxherët në rrethana të tilla mund të shikojnë vetëm përfitimet personale pa marrë në konsideratë biznesin dhe qëllimet e pronarit. Pra, edhe pse posedojnë përgatitje dhe zgjuarsi mund t’u mungojë motivi për rezultat maksimal. Pyetjet kërkimore të punimit janë: Si zhvillohet problemi “principal-agjent”? Cilat janë disa nga metodat për zgjidhjen këtij problemi? Kurse, si qëllim kryesor i punimit është analizimi dhe pasqyrimi i zhvillimit dhe zgjidhja e problemit “principal-agjent” në bizneset e komunave të rajonit të Pejës. Punimi përbëhet nga pjesa teorike, pjesa empirike, rezultatet e anketës të realizuar, prej nga rezultojnë edhe përfundimet dhe rekomandimet. Metodologjia e përdorur është ajo sasiore, ku në fillim janë dhënë hipotezat pastaj është përpiluar anketa për vërtetimin apo mohimin e hipotezave. Në këtë punim është bërë anketimi i 20 pronarëve të bizneseve, ku pronësia është e ndarë nga menaxhmenti. Si gjetje është se shumica e bizneseve ballafaqohen me problemin “principal-agjent” dhe kanë shpenzime të mëdha për mbikëqyrjen e menaxherëve. Kurse, si rekomandim është se rruga kryesore e zgjidhjes së këtij problemi është vendosja e synimeve të menaxherit në shërbim të synimeve të pronarit (aksionarëve). E kjo arrihet duke e lidhur shpërblimin e tij me performancën e biznesit.

**Fjalë kyç:** menaxhment, pronësi, principal-agjent, biznes

## Shqipëria dhe Kosova - faktor të kohezionit të sigurisë dhe paqes në Europën Juglindore

Dr. Sadri Ramabaja dhe Dr. Jeton Kelmendi

Kolegji AAB, Prishtinë

[sramabaja@gmail.com](mailto:sramabaja@gmail.com) , [jeton.kelmendi@universitetiaab.com](mailto:jeton.kelmendi@universitetiaab.com)

### Abstrakt

Çlirimi i Kosovës (qershor 1999) ishte një akt historik për Kombën Shqiptarë. Lufta e UÇK-së dhe ndërhyrja e NATO-s [1999], pra e demokracive perëndimore, i dha fund kolonializmit dhe shfrytëzimit shekullor të Kosovës nga Serbia [1912-1999]. Shpallja e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 i hapi rrugën përparimit kombëtar dhe përfundimit të procesit të krijimit gradual të shtetit-komb.

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës si dy entitete shtetërore shqiptare ndërkohë po shndërrohen në pjesë përbërëse e rendit të ri evropian. Që të dy këto republika, e para e pavarësuar nga Perandoria Osmane më 28 Nëntor 1912 dhe e dyta, Republika e Kosovës e çliruar më 12 qershor 1999 nga kolonializmi shekullor serb dhe e pavarësuar më 17 Shkurt 2008, rezultojnë të jenë si kurorëzim i natyrshëm i veprës së idealistëve shqiptarë, mbi të gjitha të tre brezave të fundit që kontribuan për çlirimin e Kosovës. Integrimin e tyre në një formë të organizimit shtetëror federal, në hap me integrimin në kuadër të BE-së, jo të jetë produkt i aktivizimit të forcave politike përparimtare në të dyja republikat ekzistuese, të cilat jam i prirur t'i cilësoj si brezi i artë i demokratëve kritikë dhe të pjekur.

Rrjedhimisht Shqipëria dhe Kosova si dy republika shqiptare duhet parë edhe si një faktor koheziv në procesin e kthimit të plotë të kombit në shtratin e tij qytetëruar autokton në frymën e qytetërimit perëndimor.

**Fjalë kyç:** Republika e Shqipërisë, Republika e Kosovës, kohezion kombëtar, shtet-kombi, ëndrra evropiane, Federata Shqiptare.

## Ballkani Perëndimor - vatër e krizave të mundshme

**Prof. Ass. Dr. Ramë Buja**

Fakulteti Administratë Publike, Kolegji AAB

Email: [ramë.buja@universitetiaab.com](mailto:ramë.buja@universitetiaab.com)

### **Abstrakt**

Ballkani Perëndimor (Kosova, Shqipëria, Serbia, Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina, Maqedonia) ishte gjatë kohë dhe për fat të keq ende mbetet vatër e krizave potenciale edhe në kohën tonë. Procesi i papërfunduar i shtetësisë së Republikës së Kosovës; problemi i pazgjidhur përfundimisht i Bosnjës dhe Hercegovinës, shkaku i 'Republikës serbe' brenda; Mali i Zi jo stabil për shkak të prezencës jo të pakët të etnisë serbe atje; Maqedonia me turbulenca pas zgjedhore, për shkak të strukturës së parlamentit dhe qeverisë, me tendenca mospranimit të Marrëveshjes së Ohrit dhe Marrëveshjes së Prespës; Serbia me regjim autokratik e totalitar, pro rus, mohues e shpërfillës i komunitetit ndërkombëtar, për çfarëdo hapi integrues; Shqipëria me probleme të brendshme, aktualisht të menaxhueshme, mbetet vendi më stabil i rajonit, me turbulenca nga një opozitë e pa konsoliduar.

Ky punim ka për qëllim të sqaroj pozitën aktuale të këtyre vendeve të rajonit tonë, duke pasur në fokus shqetësimin për mundësinë e eskalimit të situatave, me tendencë destabilizimi, me qëllim shpërqendrimi të vëmendjes nga krizat tjera aktuale.

Trajtimin do ta bëjmë për të gjitha shtetet veç e veç, duke peshuar shkallën e rrezikshmërisë së mundshme dhe mundësisë së parandalimit të tyre.

Kosova, do ta ketë vëmendjen e veçantë, për shkak të pozitës së saj aktuale, me një status akoma të papërfunduar të shtetësisë së saj në përmasa ndërkombëtare. Për shkakun e negociatave të filluara me Serbinë para më shumë se një dekade. Negociata që nuk kanë asnjë logjikë racionale as politike, as juridike as praktike pas arsyeshmërisë që i ka bërë statusit të saj GJND-ja.

**Fjalë kyç:** Kosovë, Serbi, BeH, Maqedoni e Veriut, Shqipëri, Mali i Zi.

## Menaxhimi i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës

Shqiponja Nallbani-Berisha

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: [shqiponja.nallbani@universitetiaab.com](mailto:shqiponja.nallbani@universitetiaab.com)

### Abstrakt

Arsimimi i lartë në botën moderne vlerësohet si faktor që nxit produktivitetin dhe efikasitetin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Menaxhimi i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës është një proces i vazhdueshëm që kërkon angazhim dhe përpjekje të vazhdueshme për përmirësim dhe zhvillim. Nga ky këndvështrim drejtimi modern i Universiteteve është një nga elementet e suksesit për zhvillim shoqëror-ekonomik. Qëllimi i këtij studimi është identifikimi i faktorëve që ndikojnë në Menaxhimin e Arsimit të Lartë në Kosovë. Në këtë kuadër shtrohet pyetja kërkimore një rektor i suksesshëm është ai i cili ka një qasje menaxheriale apo akademike? Në punim do të analizohet një seri teorish për mënyrat dhe modelet e suksesshme të drejtimit të cilat do të krahasohen me rezultatet e nxjerra nga pyetësori. Nga hulumtimi besueshëm është vërtetuar se një rektor i suksesshëm përveç qasjes së kombinuar gjithsesi duhet të ketë njohuri edhe më të gjera në mënyrë që të jetë koheziv në zhvillimin dhe përmirësimin e ekonomisë së bazuar në dije.

**Fjalë kyç:** arsim i lartë, universitet, menaxhim, drejtim, rektor, performancë



## Masat e ndërmarra të qeverive në rajon për zbutjen e pasojave të inflacionit pas agresionit rus mbi Ukrainën

Prof. Gëzim Selimi

Prof. Shaip Bytyqi

Kolegji AAB, Fakulteti Ekonomik, Prishtinë

[gëzim.selimi@universitetiaab.com](mailto:gëzim.selimi@universitetiaab.com), [shaip.bytyqi@universitetiaab.com](mailto:shaip.bytyqi@universitetiaab.com)

### Abstrakt

Për shkak të një rritjeje të shpejtë të shkallës së inflacionit që ka ndikuar negativisht në ekonomitë e botës, e posaçërisht në ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Serbisë, Malit të Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina), qeveritë kanë ndërmarrë një sërë masash për të stabilizuar çmimet dhe për të mbështetur sektorët ekonomikë më të prekur. Qëllimi i këtyre masave ishte të zvogëlonte ndikimin negativ të inflacionit tek konsumatorët dhe bizneset dhe njëherit të ndikonte që të promovonte një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Masat e ndërmarra, të qeverive, përfshinin përmirësimin e politikave monetare - për të kontrolluar ofertën e parasë dhe për të stabilizuar normat e interesit, si dhe masa fiskale - për të ndihmuar grupet më vulnerabël, më të rrezikuara me ndihma të drejtpërdrejta financiare dhe jofinanciare si dhe me dhënie të subvencionit për energjinë. Masat e subvencioneve dhe ndihmave direkte kanë pasur një ndikim pozitiv në uljen e çmimeve dhe në mbështetjen e bizneseve, por janë vënë re sfida në menaxhimin e burimeve dhe implementimin e politikave në disa sektorë. Masat e ndërmarra, në përgjithësi, kanë qenë efektive në stabilizimin e inflacionit dhe në ndihmën e grupeve të prekshme, por ka nevojë për përmirësime në menaxhimin e politikave dhe në strategjitë e zbatimit. Rekomandohet një rishikim i vazhdueshëm i masave dhe një përmirësim i koordinimit midis politikave monetare dhe fiskale për të përmirësuar efikasitetin dhe për të adresuar sfidat e mbetura.

**Fjalë kyç:** inflacioni, politika monetare, politika fiskale, subvencion

**Roli i marketingut strategjik në menaxhimin efikas të bizneseve të mesme dhe menaxhimi i çmimeve konkurruese në treg. Rast studimi: Fashion Group, Maqedoni**

**Prof. Asoc. Dr Ali Ismajli,  
Nazmije Morina**

Kolegji AAB Prishtinë

Email: [ali.ismajli@universitetiaab.com](mailto:ali.ismajli@universitetiaab.com)

**Abstrakti**

Është koha për transformim, konkurrencë dhe klientelë kërkuese dhe ky është një reflektim i një mjedisi shumë konkurrues. Në funksion të kësaj ngjarje, bëhet mëse e domosdoshme për të kërkuar strategji dhe mjete si ndihmë menaxheriale, sidoqoftë kur planifikimi i marketingut bëhet adekuat, i vendosur dhe orientues i veprimeve të kompanive, pavarësisht nga madhësia ose segmenti i tyre. Qëllimi i këtij punimi është të hetojë se si do të ndikojë marketingu strategjik në menaxhimin e bizneseve të mesme dhe se si ndikojnë këto strategji në menaxhimin e çmimeve dhe qëndrimin në tregjet konkurruese në Maqedoninë e Veriut. Të dhënat tregojnë se pjesa më e madhe e tyre në masën 35 % i përket grupmoshës 26-35 vjeç. Moshë 18-25 vjeç përbëjnë 30 % ndërsa moshë 36-45 vetëm 25 %. Anulimi i porosive ishte një ndër vështirësitë më të mëdha të hasura nga bizneset e ndjekur nga pagesa e qirave prej 80 %. Pagat e punonjësve dhe sigurimet ishin një kufizim tjetër në masën 70 % e ndjekur nga shlyerja e kredive dhe pagesa e llogarive të pagueshme 30 % e bizneseve raportuan se pandemia e Covid-19 shkaktoi ndërprerje totale të furnizimit ndërsa 35 % e tyre deklaruan se pati mungesë të prodhimit. Punimi advokon për politika financiare dhe fiskale që kanë për qëllim mbështetjen dhe subvencionimin e bizneseve në Maqedoninë e Veriut.

**Fjalë kyç:** Marketing, strategji, çmim, Maqedoni e Veriut, Fashion Group.

## **Transformimi i marketingut dhe rëndësia e tij gjatë kohës së pandemisë Covid-19. Rast studimi: bizneset në Republikën e Kosovës**

**Fitore Velijaj**

**Prof. Ass. Dr. Ali Ismajli**

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: [fitore2.velijaj@universitetiaab.com](mailto:fitore2.velijaj@universitetiaab.com) , [ali.ismajli@universitetiaab.com](mailto:ali.ismajli@universitetiaab.com)

### **Abstrakt**

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të arrijmë të kuptojmë se si pandemia ka ndikuar në transformimin e marketingut në përgjithësi, të ofrohen më shumë informacione rreth rëndësisë së marketingut në këtë periudhë dhe si iu janë përgjigjur këtij transformimi bizneset, e veçanërisht bizneset në Republikën e Kosovës. Për realizimin e këtij punimi, janë përdorur të dhënat parësore. Pyetësi është përdorur si instrument kryesor për të mbledhur të dhëna të rëndësishme rreth transformimit të marketingut dhe rëndësisë së tij gjatë periudhës së pandemisë Covid-19. Ky pyetësor përmban 20 pyetje të ndryshme, shpërndarja e tij është bërë drejtpërdrejt dhe online ku kemi arritur të marrim përgjigje nga 500 biznese. Nga rezultatet e këtij punimi kemi ardhur në konkluzion se periudha e pandemisë paska ndikuar në mënyrë pozitive që të kemi transformim të marketingut dhe njëkohësisht të kuptohet akoma më shumë rëndësia e tij, në një kohë ku bizneset që të funksionojnë është dashur të ndryshojnë strategjitë e tyre të marketingut. Gjetjet tregojnë se më të vërtetë mediat sociale përbëjnë një mjet të fuqishëm komunikimi gjatë pandemisë. Ky punim tutje sugjeron edhe disa rekomandime për bizneset në Republikën e Kosovës.

**Fjalë kyç:** transformim i marketingut, biznes, pandemia Covid-19, klient, marketing digjital, media sociale.

## **Ndikimi i pandemisë “Covid – 19” në stabilitetin financiar të kompanive të sigurimeve në Kosovë (Rast studimor: Kompania Scardian J.S.C)**

**Vesë Krasniqi**  
Kolegji AAB, Prishtinë  
Email: [vkrasniqi155@gmail.com](mailto:vkrasniqi155@gmail.com)

### **Abstrakt**

Ky punim është një realizim për ndikimin e një faktori të jashtëm të jashtëzakonshëm, konkretisht pandemisë Covid – 19 në sektorin e sigurimeve në Kosovë.

Punimi është bërë në pajtim me ligjet, rregullat, udhëzimet dhe politikat e rregullimit të kompanive të sigurimeve në Kosovë. Kam bërë përpjekje që të realizoj një punim mbi të cilin do të shfaq rregullimin dhe organizimin e një kompanie të sigurimeve duke vënë në pah problemet me të cilat ka hasur për të tejkaluar ndikimin e një pandemie.

Për të arritur këtë qëllim kam analizuar mënyrën e funksionimit të një kompanie të sigurimeve dhe si burim të informacioneve kam përdorur literaturë përgjithësisht online duke mos u kufizuar.

Për realizimin e rastit të studimit kam përdorur mënyrën e mbledhjes së të dhënave përmes pyetësorëve, e cila është një mënyrë e drejtpërdrejt për të arritur në grumbullimin e të dhënave primare dhe duke i përdorur në vazhdimësi në këtë punim. Realizimi i këtij punimi ka kërkuar një fokus të posaçëm në raportet e publikuara të kompanisë përkatësisht raportet tremujore, vjetore pasi përmes tyre kemi arritur t'i mbledhim të dhënat e kërkuara dhe të arrijmë në objektivat e caktuara.

Punimi përmban të dhëna të cilat janë të shprehura në vlera të ndryshme monetare, të cilat i përkasin kursit të këmbimit të kohës kur janë raportuar ato të dhëna. Pra, që të dhënat të jenë sa më të sakta, ato janë shprehur në vlerat monetare të cilat i përkasin atij vendi dhe për të cilat do të njoftoheni para çdo të dhëne.

**Fjalë kyç:** Kosovë, pandemi, sigurime, kurs këmbimi, raporte

## Ndikimi i Marrëveshjeve Tregtare në Promovimin e Stabilitetit Rajonal

**Pranvera Dalloshi**

Kolegji AAB

Email: [pranvera.dalloshi@universitetiaab.com](mailto:pranvera.dalloshi@universitetiaab.com)

**Mentor Borovci**

Kolegji AAB

Email: [mentor.borovci@universitetiaab.com](mailto:mentor.borovci@universitetiaab.com)

### **Abstrakt**

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë një histori të gjatë të konflikteve ndërfqinjësore. Shembja e Murit të Berlinit dhe rënia e sistemit monist, dhe fillimi i demokratizimit të këtyre vendeve, ka shtruar nevojën e nxitjes së bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar, si e vetmja mënyrë për të lënë pas të kaluarën konfliktuale dhe për të ecur përpara në rrugën e integritit të tyre në Bashkimin Evropian. Konfliktet e viteve të 90-ta kanë ndikuar që ky rajon të mos jetë mjaftueshëm ekonomikisht i zhvilluar, por literatura tregon se rritja e marrëdhënieve tregtare mund të ulë probabilitetin e konflikteve ushtarake (Huang, Q. & Li, Zh., 2024). Në këtë kontekst, ky punim synon të ofrojë një analizë gjithëpërfshirëse se si marrëveshjet tregtare si CEFTA dhe MSA kanë ndikuar në rritjen e oportunitetit të kompanive prodhuese kosovare për të eksportuar. Për këtë qëllim janë përdorur të dhënat primare. Të dhënat janë mbledhur përmes anketave nga 78 kompani prodhuese me bazë në Kosovë, për të vlerësuar sfidat dhe oportunitetet për të eksportuar në rajon, BE dhe më gjerë. Analizat empirike zbulojnë se të kuptuarit dhe tejkalimi i sfidave për rritjen e tregtisë ndërkombëtare mund të nxisë rritjen e marrëdhënieve tregtare. Hulumtimi nënvizon rëndësinë e politikave mbështetëse për të lehtësuar procesin e eksportit. Gjetjet janë të vlefshme veçanërisht për politikëbërësit dhe bizneset joeksportuese, duke ofruar një kornizë për lehtësimin e tranzicionit drejt eksportit dhe rritjes së tij.

**Fjalë kyç:** marrëveshjet tregtare, stabiliteti ekonomik, eksportet, bashkëpunimi ndërshtetëror.

## Demokratizimi i brendshëm në Serbi si kusht për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi

**Prof. Ass. Dr. Donik Sallova**

Fakulteti Administratë Publike, Kolegji AAB

Email: [donik.sallova@aab-edu.net](mailto:donik.sallova@aab-edu.net)

### **Abstrakt**

Prej 15 vitesh Bashkimi Evropian bën përpjekje për të normalizuar marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si një nga kontestet më të rëndësishme zgjidhja e të cilit do të çonte kah një stabilitet më i qëndrueshëm në Ballkanin Perëndimor. Përveç se është negociuar mes dy palësh që nuk e trajtojnë njëra tjetrën në mënyrë të barabartë, përkatësisht Serbia refuzon ta njoh Kosovën si shtet, një aspekt fundamental që i dallon palët e që ka ndikuar në progresin e dialogut është edhe natyra e regjimeve që ato përfaqësojnë. Qëllimi i këtij punimi është të argumentojmë rëndësinë që ka demokracia e brendshme në ndërtimin e fqinjësisë së mirë në mes të Kosovës dhe Serbisë në veçanti, por edhe në forcimin e stabilitetit rajonal në përgjithësi. Punimi do të synojë të mbështesë supozimin bazë se pa një demokratizim të brendshëm dhe real të Serbisë, nuk do të mund të ketë normalizim të raporteve ndërfqinjësore dhe njohje reciproke Kosovë-Serbi. Në punim do të paraqiten shembuj krahasues nga rajone të ndryshme të botës ku stabiliteti i cili nuk është mbështetur mbi regjime të mirëfillta demokratike ka rezultuar i paqëndrueshëm dhe ka riprodhuar konflikte dhe regres. Punimi nxjerr si përfundim kryesor se demokratizimi i brendshëm i shteteve rezulton me ndikim edhe në përmirësimin e marrëdhënieve ndër-fqinjësore mes shteteve, gjë e cila vlen veçanërisht edhe për marrëdhëniet Serbi-Kosovë.

**Fjalë kyç:** demokratizim, normalizim, fqinjësi, stabilitet, Kosovë, Serbi.

## **Ndikimi i sistemet informativ të kontabilitetit në performancën e korporatave të mëdha - rast studimi: HIB Petrol**

**Prof. Asst. Dr. Medain Hashani**

Email: [medain.hashani@universitetiaab.com](mailto:medain.hashani@universitetiaab.com)

**MSc. Rilind Shabani**

Email: [rilind3.shabani@universitetiaab.com](mailto:rilind3.shabani@universitetiaab.com)

### **Abstrakt**

Funksionimi modern i çdo kompanie sot është i paimagjinueshëm pa aplikimin e teknologjisë informative dhe komunikuese në të gjitha njësitë organizative. Kontabiliteti është një aktivitet i cili është i ndikuar shumë nga zhvillimi i vullshëm i risive teknologjike. Me aplikimin e sistemeve informative në kontabilitet, realizimi i proceseve dhe aktiviteteve lehtësohet shumë, është më i shpejtë dhe reduktohen kostot operative dhe financiare të biznesit. Përpunimi kompjuterik i të dhënave dhe i llogaritjeve financiare kontribuon në saktësinë, përditësimin dhe filtrimin e të dhënave të disponueshme. Në këtë mënyrë disponueshmëria e të gjitha informatave kontabël në bazën e të dhënave bëhet lehtësisht e qasshme për punonjësit të cilët informatat kontabël mund t'i arrijnë me një kërkim të thjeshtë dhe të shpejtë.

Qëllimi i këtij punimi është të trajtojë çështjet teorike dhe praktike dhe rëndësinë e sistemeve informative të kontabilitetit dhe të tregojë ndikimin e tyre në performancën e korporatave, pastaj funksionalitetin e këtyre sistemeve në praktikë, duke përdorur shembullin e procesit të funksionimit të sistemit informativ të kontabilitetit në korporatën HIB Petrol.

Analiza e korrelacionit, ofron dëshmi empirike të marrëdhënieve midis zbatimit të sistemeve informative të kontabilitetit dhe performancës së korporatës, duke mbështetur hipotezën se përdorimi efektiv i sistemeve informative është një shtytës kritik i suksesit financiar.

**Fjalë kyç:** Sistemet informative, korporata, kontabiliteti, analiza.

# Ndryshimi i tregut të punës në Kosovë nën ndikimin e tendencave teknologjike

**Prof. Asoc. Dr. Lulzim Shabani**

Email: [lulzim.shabani@universitetiaab.com](mailto:lulzim.shabani@universitetiaab.com)

**MSc. Armend Aliu**

Email: [armend6.aliu@universitetiaab.com](mailto:armend6.aliu@universitetiaab.com)

## Abstrakt

Revolucioni i Katërt Industrial po ndikon fuqishëm në automatizimit dhe robotizimit e proceseve. Një tranzicioni i tillë i ri shkaktohet nga inovacionet industriale siç është interneti i gjërave, teknologjia blockchain, teknologjia cloud, zhvillimi i robotikës, prodhimi plotësisht i automatizuar, të dhëna të mëdha dhe analiza të mëdha, pajisjet robotike, bioteknologjia dhe inovacione të tjera teknologjike që i shërbejnë zhvillimit të industrisë së zgjuar. Në këtë kontest është shtruar edhe pyetja kërkimore se si të rinjtë i perceptojnë këto ndryshime të cilat kanë ndryshuar tregun e punës.

Qëllimi i punimit është të identifikojë dhe përshkruajë perceptimin dhe qëndrimet e të rinjve, veçanërisht të studentëve të disa profileve në disa qytete të Kosovës, në lidhje me ndryshimet e shkaktuara nga Revolucionit i Katërt Industrial që ndryshoj tregun e punës dhe natyrën e punës, duke qenë se janë ata që përbëjnë fuqinë punëtore që hyn në tregun e punës dhe që do të ndikohen nga tendencat e automatizimit, robotizimit dhe ndryshimeve të tjera teknologjike. Punimi ofron një pasqyrë më të thellë mbi ndryshimet në tregun e punës të shkaktuara nga tendencat teknologjike të Revolucionit të Katërt Industrial, si dhe trajton mënyrën se si të rinjtë i perceptojnë këto ndryshime.

Rezultatet tregojnë se të rinjtë kryesisht mendojnë se automatizimi dhe robotizimi do të rezultojë në humbjen e një numri të madh të vendeve ekzistuese të punës, por edhe në krijimin e vendeve të reja të punës. Ata janë të gatshëm të mësojnë gjatë gjithë shekullit të tyre të punës dhe rrjedhimisht të fitojnë aftësi të reja të nevojshme për tu përshtatur me ndryshimet në tregun e punës.

**Fjalë kyç:** Revolucioni industrial, industria 4.0, automatizimi, robotizimi, tregu i punës.



## **Sfidat e menaxhimit të burimeve njerëzore te kompanitë që operojnë brenda industrisë 4.0 në Republikën e Kosovës**

**MSc. Altin Hoxha**

Email: [altin2.hoxha@universitetiaab.com](mailto:altin2.hoxha@universitetiaab.com)

**Prof.Asoc. Dr. Lulzim Shabani**

Email: [lulzim.shabani@universitetiaab.com](mailto:lulzim.shabani@universitetiaab.com)

### **Abstrakt**

Një nga fushat që po ndikohet më së shumti nga Industria 4.0 është edhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore. Zbatimi i saj po bën progres gjithnjë e më shumë në nivel global. Rekrutimi i një fuqie punëtore cilësore dhe menaxhimi i saj është një detyrë themelore në epokën e ndryshimeve të ndikuara nga Industria 4.0. Me ardhjen e kësaj industrie, menaxhimi i burimeve njerëzore po përballlet me shumë sfida si, profilet e reja të punës, arsimimi, punësimi, etj.

Qëllimi i punimit është trajtimi i Industrisë 4.0 dhe menaxhimi i burimeve njerëzore, bazuar në shembujt e disa kompanive në Republikën e Kosovës.

Në bazë të hulumtimit, është evidente se kompanitë në Republikën e Kosovës janë të njohura me konceptin e Industrisë 4.0 dhe segmentet e saj dhe se ato po e ndjekin trendet globale të transformimit digjital. Kompanitë në Republikën e Kosovës duhet të pajtohen se Industria 4.0 paraqet sfidën e gjetjes së një fuqie punëtore kompetente që ka njohuri në teknologji informative dhe aftësi sociale cilësore përballë menaxhimit të burimeve njerëzore.

**Fjalë kyç:** Industria 4.0, burimet njerëzore, teknologjia, punësimi, arsimimi.

## Çmimet tavan - masë e luftimit të inflacionit nga Qeveria në Kosovë

Prof Ass. Dr.Sc Remzi Smajli

Kolegji AAB

Email: [remzi.smajli@universitetiaab.com](mailto:remzi.smajli@universitetiaab.com)

### Abstrakt

Dukuria e ekspansionit ekonomik pas pandemisë Covid 2019, ndër të tjera pati si pasojë edhe ngritjen e çmimeve përpos ndikimit në paritetin valutor të valutave kombëtare. Ky fenomen i ngritjes së çmimeve, normalisht shkaktoi edhe dukurin e inflacionit të rritur madje në nivele ndërkombëtar.

I ndikuar nga kjo furtunë inflatore nuk mbeti pa u prekur edhe shteti i Kosovës si një ndër vendet e Ballkanit perëndimor dhe kontinentit Evropian, me një ekonomi frigjide dhe të ndjeshme nga proceset e lëvizjes së normave të interesit në tregjet botërorë.

Përcaktimi i qeverisë në diktimin e çmimeve të produkteve kryesore sidomos naftës dhe disa produkteve ushqimore lënë për të rrezikuar përcaktimin e këtij vendi në rrugën e saj konsekuente për ekonominë e tregut.

Qëllimi i punimit është hulumtimi i masave të përdorura nga qeveria e Kosovës për luftimin e dukurisë së inflacionit të shkaktuar në norma deri në 17 % në bazë mujore dhe në masën 12 % në nivel vjetor në vitin 2022 dhe ndikimi i tyre në zvogëlimin e inflacionit. Metoda e përdorur në këtë hulumtim konsistojnë në përzgjedhjen e variablave të pavarura që janë çmimet e produkteve dhe pariteti valutor kundrejt variablës së varur nivelin e inflacionit, gjithnjë duke përdorë burimet dytësorë të të dhënave në hulumtim. Nga ky hulumtim gjejmë se masat e përdorura nga qeveria, në veçanti përcaktimi i çmimeve tavan, nuk ishin masa adekuate për zvogëlimin e inflacionit edhe për arsyen se këto masa hasen në rezistencën e operatorëve ekonomik dhe partnerëve social në këtë proces.

Përfundimet nga ky hulumtim na dërgojnë në adresimin e vërejtjeve e sugjerimeve për qeverinë në zbatimin e reformave adekuate për luftimin e inflacionit të përkohshëm në Kosovë.

**Fjalë kyç:** Inflacion, çmime, monedha, masa ekonomike, qeveria.

# Inflacioni dhe vështirësitë ekonomike pas agresionit rus: një analizë për ekonominë shqiptare

**Blerta Haliti Baruti**

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë  
Email: [blerta.haliti@universitetiaab.com](mailto:blerta.haliti@universitetiaab.com)

**Armanda Tola**

Universiteti Epoka, Tiranë, Shqipëri  
Email: [atola@epoka.edu.al](mailto:atola@epoka.edu.al)

## Abstrakt

Agresioni rus ndaj Ukrainës, që filloi në shkurt të vitit 2022, ka pasur pasojë të ndjeshme ekonomike globale, duke përfshirë një rritje të inflacionit dhe vështirësimin e mirëqenies në Kosovë dhe Shqipëri. Ky studim synon të analizojë ndikimet specifike të këtyre ngjarjeve në ekonominë e Kosovës dhe Shqipërisë, duke u fokusuar në faktorët e inflacionit dhe masat e ndërmarra nga qeveritë për të zbutur këto ndikime. Metodën e përdorur për të përshkruar një analizë të të dhënave nga institucionet vendore si Agjencia e Statistikave të Kosovës, Instituti i Statistikave të Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave të dy vendeve për periudhën 2023-2025, si dhe burime ndërkombëtare si Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Për analizimin e marrëdhënieve midis ndryshimeve në çmimet e energjisë, ushqimit dhe inflacionit në Kosovë dhe Shqipëri, u përdorën modele ekonometrike të regresionit dhe ARIMA (Auto Regressive Integrated Moving Average) për të parashikuar trendet e inflacionit. Gjetjet tregojnë se çmimet e energjisë dhe ushqimeve janë rritur ndjeshëm, duke ndikuar negativisht në fuqinë blerëse të qytetarëve dhe mirëqenien ekonomike në të dyja vendet. Politikat monetare dhe masat sociale kanë ndihmuar në stabilizimin e situatës, por sfidat mbeten të mëdha. Përfundimisht, rekomandohet diversifikimi i ekonomive, përmirësimi i politikave fiskale dhe vazhdimi i mbështetjes për grupet më të cenueshme për të siguruar një rimëkëmbje të qëndrueshme.

**Fjalë kyç:** inflacion, mirëqenie, agresioni rus, Kosovë, Shqipëri

# Qëllime të qëndrueshme në zhvillim të (pa)qëndrueshëm: Aplikimi i standardeve ESG në Kosovë

**Brikena Berisha**

Kolegji AAB, Fakulteti Ekonomik &  
Universiteti i Lubjanës, Fakulteti për Ekonomi dhe Biznes  
Email: [brikena.berisha@universitetiaab.com](mailto:brikena.berisha@universitetiaab.com)

## **Abstrakt**

Rëndësia e qëndrueshmërisë është duke u rritur në tregti. Përgjegjësia sociale e korporatave (CSR), apo standardet e mjedisit, shoqërore dhe të qeverisjes (ESG) janë disa nga konceptet që masin vlerën e një kompanie në aspekte të ndryshme. Nga qershori i vitit 2023, Komisioni Evropian ka miratuar standardet e raportimit, ndërsa nga 1 Janar 2024 ky raportim është i obligueshëm për kompanitë e mëdha (*Komisioni Evropian, 2023*). Edhe pse kjo nuk i prek direkt, kompanitë e vogla dhe të mesme (NMV-të) duhet të kenë përgjegjësi në kur bashkëpunojnë me kompanitë e mëdha në zingjirin e furnizimit.

Marrë parasysh rëndësinë në rritje të standardeve ESG në rolin mjedisor, social dhe qeverisës të kompanisë (*Dahlsrud, 2008*), ky studim mëton të pasqyrojë vetëdijësimin dhe implementimin e këtyre standardeve në kompanitë kosovare. Të dhënat janë marrur nga 42 kompani të tekstit në Kosovë, me hulumtim të përqendruar drejtpërdrejtë me nga dy menaxherë brenda kompanisë dhe nga 2 punëtorë, gjithsej 197 punëtorë. Të gjeturat ngrisin shqetësime lidhur me njohurinë dhe zbatueshmërinë e standardeve ESG në kompanitë kosovare, qëndrueshmërinë e këtyre kompanive si dhe aftësinë e përgjigjes së tyre ndaj krizave. Studimi konstaton se qëndrueshmëria e kompanive në Kosovë në aspektin mjedisor, shoqëror dhe qeverisës është e lidhur me nivelin e tyre të eksportit. Kjo do të thotë se kompanitë që eksportojnë e kanë të imponuar implementimin e disa standardeve që tërthorazi ndikojnë edhe në qëndrueshmërinë sociale, qeverisëse dhe ambientit.

**Fjalë kyç:** qëndrueshmëria, standardet ESG, eksporti, Kosovë

## Sfidat për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës në vitet e ardhshme

**Arburim Shabani**

Email: [arburim.shabani@aab-edu.net](mailto:arburim.shabani@aab-edu.net)

Kolegji AAB, Prishtinë

**Medain Hashani**

Email: [medain.hashani@aab-edu.net](mailto:medain.hashani@aab-edu.net)

Kolegji AAB, Prishtinë

**Ilir Bytyçi**

Email: [ilir.bytyqi@aab-edu.net](mailto:ilir.bytyqi@aab-edu.net)

### **Abstrakt**

Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik synon të plotësojë nevojat e së tashmes por me synim të krijoj stabilitet dhe tendencë të zhvillimit edhe në të ardhmen. Derisa zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik në përgjithësi përballet me shumë sfida dhe çështje të karakterit politik, social, mjedisor por edhe të shëndetit publik, Kosova në relacion me rajonin në veçanti karakterizohet edhe me tensione të herëpashershme politike që tangojnë edhe çështje të sigurisë të cilat sfidojnë në shkallë të madhe bizneset dhe zhvillimin ekonomik. Kështu, qëllimi i këtij punimi është që të analizojë ambientin biznesor në Kosovë; lëvizjet dhe ndryshimet politike dhe fiskale, ndikimin e tyre në ekonomi si dhe identifikimin e faktorëve kryesor që stimulojnë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Në këtë drejtim shtrohet pyetja kërkimore se cilët janë faktorët kryesor që ndikojnë në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në Kosovë. Në punim do të analizohen rrethanat dhe faktorët që kanë ndikim dhe kushtëzojnë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe rrjedhimisht edhe stabilitet. Rezultatet nga ky punim tregojnë se faktorët kryesor për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik duhet të mbështeten në harmonizimin e elementeve të sigurisë, infrastrukturës, lehtësimeve procedurale si dhe përvetësimit të formave të reja të zhvillimit të biznesit, nëpërmjet inovacioneve në produkte, procese dhe shërbime.

**Fjalë kyç:** zhvillim i qëndrueshëm ekonomik, biznes, Kosova, siguria, inovacione.

# Lufta në Ukrainë dhe impakti në trendet inflacioniste globale dhe qëndrueshmërinë ekonomike

**Prof. Florije Miftari**

Fakulteti Ekonomik, Kolegji AAB

Email: [florije.miftari@universitetiaab.com](mailto:florije.miftari@universitetiaab.com)

## **Abstrakt**

Inflacioni është një faktor kritik në sigurimin e rritjes së qëndrueshme ekonomike të një vendi. Në përgjithësi, aspekti ekonomik i zhvillimit të qëndrueshëm përfshin shëndetin e përgjithshëm të ekonomisë. Treguesit kryesorë makroekonomikë, si normat e papunësisë dhe inflacionit, janë vendimtare për vlerësimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Së fundmi, konflikti i vazhdueshëm Rusi-Ukrainë, filluar në shkurt 2022, ka pasur pasojë të thella dhe të gjera edhe në ekonominë globale, veçanërisht në lidhje me tendencat e inflacionit dhe qëndrueshmërinë ekonomike. Qëllimi i këtij punimi është të analizojë marrëdhënien komplekse midis konfliktit dhe pasojave të tij ekonomike, duke u fokusuar në mënyrën se si lufta ka ndikuar në presionet inflacioniste në rajone të ndryshme me theks të veçantë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Analiza përfshinë ndërprerjet në zinxhirët e furnizimit global, paqëndrueshmërinë në tregjet e energjisë dhe të mallrave dhe ndryshimet në dinamikën e tregtisë ndërkombëtare. Duke përdorur modele ekonometrike të regresionit, ky studim vlerëson ndikimet e menjëhershme dhe afatgjata të konfliktit në normat e inflacionit dhe stabilitetin ekonomik. Gjetjet tregojnë se lufta ka përkeqësuar tendencat inflacioniste, me rritje të ndjeshme të çmimeve të energjisë, lëndëve të para ushqimeve, etj. Për më tepër, studimi thekson se si këto presione inflacioniste kanë çuar në sfida më të gjera ekonomike, duke përfshirë uljen e fuqisë blerëse dhe pasiguri të shtuar në tregjet globale.

**Fjalë kyç:** lufta Rusi-Ukrainë, inflacioni, çmimet, qëndrueshmëria ekonomike.

# Administrata publike dhe sfidat e euroskepticizmit në Ballkanin Perëndimor

Prof. ass. Dr. Melihate Tërmkolli

Fakulteti i Administratës Publike, Kolegji AAB

Email: [melihate.termkolli@universitetiaab.com](mailto:melihate.termkolli@universitetiaab.com)

## Abstrakt

Administrata publike në vendet e Ballkanit Perëndimor ose Evropës Jug-Lindore përballet me probleme dhe sfida të mëdha. Në veçanti në rrethana të euroskepticizmit të shtuar në shumë shtete evropiane që kulmuan me zgjedhjet e qershorit 2024 për Parlamentin Evropian, sfidat bëhen edhe më të mëdha e më domethënëse.

Roli i administratës publike është crucial në procesin integruues evropian sidomos në vendet që aspirojnë integrimin. Administrata publike përbën faktorin kyç të përbushjes së standardeve të përcaktuara nga BE-ja si *acquis communautaire* ndonëse ende nuk ka një kodifikim të plotë për këtë fushë në nivel të BE-së. Arsyet politike janë më të shumta rreth euroskepticizmit e që janë të ndikuara direkt nga neglizhenca dhe standardet e dyfishta të BE-së në raport me vendet e Ballkanit Perëndimor të cilat kanë krijuar edhe situata të zbehjes së demokratizimit në këto vende. Shumë prej tyre tashmë kanë regjime autokratike ndërsa BE i favorizon pa hezitim duke ndëshkuar vende si Kosova etj. që në shumicë dërmuese kanë shfaqur orientim pro integritit evropian.

Ndonëse është rritur roli i administratës edhe në politikëbërje, euroskepticizmi është pasojë direkte e politikave të gabuara të BE-së dhe në një masë edhe e politikave respektive të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Administrata publike në këtë situatë mund të marrë rol aktiv në qartësimin e detyrave integruuese evropiane.

**Fjalë kyç:** administrata publike, euroskepticizmi, integrimi evropian, sfidat, Ballkani Perëndimor

## Qeverisja dhe lehtësira e të bërit biznes, si një nga sfidat në rajonin tonë

**Dr.Sc. Basri Sadriu**

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: [b\\_sadriu@hotmail.com](mailto:b_sadriu@hotmail.com)

**Ph.D.c. Mirsad Sadriu**

Raiffeisen Bank Kosovo, Prishtinë

Email: [mirsadsadriu@hotmail.com](mailto:mirsadsadriu@hotmail.com)

### **Abstrakt**

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të analizojë nëse qeverisja dhe lehtësira e të bërit biznes paraqesin sfidë të veçantë për rajonin tonë. Për këtë qëllim, në këtë hulumtim, qeverisja si nocion është e përfaqësuar nga indikatorët e qeverisjes, ndërsa lehtësira e të bërit biznes përfaqësohet nga indikatorët e lehtësirave e të bërit biznes, të cilat burimin e kanë në data bazën e Bankës Botërore. Duke marrë parasysh që të dhënat e përdorura në këtë studim janë të dhëna sekondare kuantitative, edhe metodat e përdorura janë metoda kuantitative. Ndërsa, qasja e përdorur është qasje deduktive, ku do të fillohet me ngritjen e pyetjeve hulumtuese, dhe pastaj përmes të dhënave të mbledhura të nxirren konkluzionet përfundimtare, me theks të veçantë tek analiza krahasuese përmes grafeve. Rezultatet kanë treguar, së për të dy grupet e indikatorëve, vendet e rajonit stagnojnë krahasuar me vendet e tjera Evropiane, kështu duke demonstruar një ambient më pak të sigurt ekonomik, specifikisht në aspektin e investimeve. Implikimet në këtë hulumtim fokusohen vetëm në mungesën e të dhënave zyrtare për vitet pas vitit 2020, për indikatorët e lehtësirës të së bërit biznes, gjë që nuk na lejojnë që analizën ta vazhdojmë edhe tek vitet e fundit që lamë pas.

**Fjalë kyç:** qeverisje, biznes, mjedis, ekonomike, lehtësira.



## Gruaja, kontribuuese për paqe dhe stabilitet në rajonet e trazuar

**Ganimete Ismaili, PhD Cand.**

Kolegji AAB, Fakulteti Juridik &

Universiteti i Sarajevës, Fakulteti për kriminalistikë, kriminologji dhe studime të sigurisë

Email: [ganimete.ismajli@universitetiaab.com](mailto:ganimete.ismajli@universitetiaab.com)

### Abstrakt

Qëndrueshmëria e një shteti ligjor dhe cilësia e demokracisë manifestohet edhe përmes barazisë gjinore. Barazia gjinore nuk është më vetëm synim, kriter apo objektivi i demokracive bashkëkohore por një realitet ekzistues i arritur me shumë përpjekje dhe sakrifica.

Në fushën e Sigurisë, gratë kanë pasur dhe gjithnjë e më shumë po dëshmojnë se kanë rol të rëndësishëm dhe të barabartë përkrah burrave. Këtë tezë e mbështesim edhe në pjesëmarrjen aktive të grave në luftërat mbrojtëse gjatë shpërbërjes së dhunshme të ish-Jugosllavisë dhe luftës së fundit në Ukrainë. Jo vetëm pjesëmarrja në luftëra, por edhe kontributi dhe angazhimi aktiv i gruas si lidere në përfaqësim dhe vendim-marrëse në institucionet më vitale të shtetit si në polici, ushtri dhe agjencione të tjera për zbatimin e ligjit, tregon se nuk ka më profesione vetëm për burra dhe profesione vetëm për gra.

Padyshim dje, sot dhe nesër, roli dhe kontributi i gruas si lidere dhe promotore në promovimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës është thelbësor për sigurimin e paqes dhe stabilitetit në rajonet e trazuar pasi që përpjekjet e tyre për barazi gjinore dhe drejtësi sociale krijojnë një shoqëri më të drejtë dhe të barabartë, duke siguruar themelet për një paqe të qëndrueshme.

**Fjalë kyç:** siguria, sundimi i ligjit, stabiliteti, barazia gjinore, siguria kolektive

## **Ndikimi i kulturës organizative në motivimin e punëtorëve të organizatave ndërkombëtare në Kosovë**

**Msc. Violeta Ukça,**

**Kolegji AAB**

Email: [violeta.ukca@universitetiaab.com](mailto:violeta.ukca@universitetiaab.com)

**Msc. Nazlije Geci Halimi,**

**Kolegji AAB**

Email: [nazlije.halimi@gmail.com](mailto:nazlije.halimi@gmail.com)

### **Abstrakt**

Ky studim ka për qëllim hulumtimin e kulturës organizative në organizatat ndërkombëtare të Kosovës dhe ndikimin e saj në punëtorët e tyre vendorë, duke u përqendruar në identifikimin e elementeve kryesore të kulturës organizative, ndikimin e saj në kënaqësinë e punës dhe motivimin e punëtorëve. Duke u nisur nga literatura e mëparshme që vë në dukje rëndësinë e kulturës organizative në performancën e organizatës dhe motivimin e punëtorëve, ky studim synon të përforcojë këtë kuptim në kontekstin e organizatave në Kosovë.

Metoda e përdorur në punim është metoda sasiore. Të dhënat empirike janë mbledhur përmes një pyetësoi i cili është shpërndarë tek 65 punëtorë vendorë të organizatave ndërkombëtare në Kosovë dhe ato janë analizuar përmes programit SPSS. Me përdorimin e testeve statistikore, përfshirë Spearman Correlation dhe Chi-Square Test of Independence, studimi konfirmoi se kultura organizative ka një ndikim pozitiv dhe të rëndësishëm në motivimin dhe performancën e punëtorëve dhe me këtë i vërtetoi të dy hipotezat e ngritura.

Rezultatet treguan se organizatat ndërkombëtare në Kosovë kultivojnë një kulturë organizative të fortë dhe pozitive, e cila përfshin diversitetin kulturor, stilet e lidhshpimit ndërkombëtar, komunikimin efektiv dhe transparencën. Megjithatë, rekomandimi kryesor ishte përmirësimi i mundësive të ngritjes në karrierë për punëtorët vendorë dhe njohja e tyre e barabartë me kolegët ndërkombëtarë.

Bazuar në këto gjetje, ky studim kontribuon në kuptimin e rëndësisë së kulturës organizative për motivimin e punëtorëve në kontekste ndërkombëtare dhe sugjeron masa konkrete për përmirësimin e praktikave menaxheriale në Kosovë.

**Fjalë kyç:** kultura organizative, organizatat ndërkombëtare, ndikimi i kulturës organizative, motivimi, punëtorët

## **Roli i vlerësimit të performancës në produktivitetin e punëtorëve në sektorin bankar në Kosovë**

**Msc. Nazlije Geci Halimi,**

Kolegji AAB

Email: [nazlije.halimi@gmail.com](mailto:nazlije.halimi@gmail.com)

**Msc. Violeta Uçka,**

Kolegji AAB

Email: [violeta.ukca@universitetiaab.com](mailto:violeta.ukca@universitetiaab.com)

### **Abstrakt**

Qëllimi i këtij studimi është të matet ndikimi i vlerësimeve formale të performancës në produktivitetin e punëtorëve në sektorin bankar në Kosovë. Ky studim synon të kuptojë nivelin e kënaqësisë së punëtorëve me procesin e vlerësimit të performancës, perceptimin e tyre për këtë proces dhe ndikimin që ka ky proces në motivimin dhe produktivitetin e tyre në punë. Metodatat e përdorura për përmbledhjen e të dhënave përfshijnë teori të ndryshme dhe të dhëna sasiore dhe empirike të mbledhura nga punonjës të sektorit bankar në Kosovë. Gjetjet e studimit tregojnë se vlerësimi i performancës ka ndikim pozitiv në produktivitetin e punëtorëve, duke rritur nivelin e motivimit dhe kënaqësisë në punë. Për më tepër, gjetjet tregojnë se punëtorët që marrin vlerësime të rregullta dhe konstruktive janë më të angazhuar dhe kanë performancë më të mirë në përmbushjen e detyrave të tyre. Një tjetër gjetje e rëndësishme është se procesi i vlerësimit të performancës kontribuon në ndërtimin e një mjedisi pune më të hapur dhe transparent, ku punonjësit ndihen të vlerësuar dhe të motivuar për të arritur objektivat e tyre personale dhe ato të organizatës. Ky studim ofron rekomandime konkrete për të përmirësuar motivimin e punëtorëve në sektorin bankar në Kosovë, duke kontribuar në përmirësimin e performancës dhe rritjen e produktivitetit të tyre në këtë sektor.

**Fjalë kyç:** Vlerësimi i Performancës; Produktiviteti; Motivimi; Efikasiteti; Menaxhimi i Performancës.

# Ndikimi i auditimit të brendshëm në performancën menaxheriale" Rast studimi: Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë

**Burim Hasani**

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: [burim2.hasani@universitetiaab.com](mailto:burim2.hasani@universitetiaab.com)

## **Abstrakt**

Ky studim analizon rolin dhe rëndësinë e auditimit, auditimit të brendshëm në veçanti dhe ndikimin e tij në performancën menaxheriale në sektorin e arsimit të lartë në Kosovë, duke u fokusuar në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë. Studimi ofron një analizë të detajuar teorike dhe praktike përmes kërkimit bibliografik dhe analizës së të dhënave, duke paraqitur historinë e auditimit, ndarjen midis auditimit të jashtëm dhe të brendshëm, si dhe llojet e auditimit në sektorin publik. Studimi gjithashtu analizon aspektin legjislativ dhe procesin e planifikimit të auditimit të brendshëm në Kosovë, si dhe ndikimin i tij në performancën menaxheriale të institucioneve të arsimit të lartë, analizën se si raportet e auditimit të jashtëm ndikojnë në proceset e kontrollit të brendshëm në universitetet publike në Kosovë.

Përfundimet synojnë të thellojnë kuptimin e lidhjes midis auditimit të brendshëm dhe performancës menaxheriale, bazuar në teoritë, praktikat dhe analizën e të dhënave nga pyetjet kërkimore me auditorë, profesorë, staf menaxherial, administrativ dhe studentë të universiteteve publike. Ky studim ofron njohuri të vlefshme për profesionistët e auditimit dhe të financave publike, duke synuar përmirësimin e praktikave të kontrolleve të brendshme.

**Fjalë kyç:** auditim, kontrollë, performancë, menaxhim, universitetet, raporte.

## *Haking dhe testi i depërtimit me kali-linux*

**Fisnik Gojani**

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: [fisnik.gojani@universitetiaab.com](mailto:fisnik.gojani@universitetiaab.com)

### **Abstrakt**

Numri i madh shpikjeve dhe zhvillimi i madh i teknologjisë na ka bërë të gjithëve të pajisur me pajisje teknologjike, ndërsa informacioni dhe të dhënat po dyfishohet nga viti në vit, ku shumica e njerëzve nuk kanë as njohurit bazë për atë që po bëjnë ose ku i përdorin pajisjet e tyre dhe të dhënat që i ndajnë në internet, kjo është nder arsyet për të gjitha krimet kibernetike që behën në ditët e sodit dhe keqpërdorimet.

Ky punim i dedikohet fushës së sigurisë kibernetike për të parë me afër se si bëhet një hakim në jetën e përditshme nga hakerët dhe mënyrat që përdoren në botën moderne. Hakimi është një proces ku hakeri i merr qasjet viktimës në mënyrë të pa autorizuar. Fatkeqësisht të dhënat tona dhe informacionet që i ndajmë në internet nuk janë aspak të sigurta.

Prandaj është përgjegjësi e secilit nga ne për të përdorur pajisjet sa më sigurt dhe të jemi të vetëdijshme se çka po bëjmë në telefona, laptopa, tableta sepse jemi të kërcënuar në çdo moment nga keqbërësit sepse një gabim i vogël nga ana e jonë mund të shkojë gjithçka në dorën e gabuar. Siguria e pajisjeve dhe të dhënave është gjeja më e rëndësishme në ditët e sodit si për persona ashtu edhe për kompanitë, pasi edhe numri i hakerëve është rritur. Ky punim do të mbulojë disa forma të hakimit dhe teknika në ambiente të izoluar për testim.

**Fjalë kyç:** hakim, siguria, të dhënat, krime kibernetike, internet.

## Emrat e huazuar frëng nga fusha e administratës publike dhe juridikut në anglishten moderne: Rast studimi: "L'Étranger" i Albert Kamy-së

Gresa Shaqiri

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: [gresa.shaqiri@universitetiaab.com](mailto:gresa.shaqiri@universitetiaab.com)

### Abstrakt

Ky studim eksploron ndikimin e thellë dhe të qëndrueshëm të gjuhës frënge në terminologjinë e fushave të administratës publike dhe juridikut të gjuhës angleze. Pas pushtimit norman të Anglisë në vitin 1066, gjuha frënge u bë gjuha zyrtare e administratës dhe sistemit ligjor. Si rezultat, shumë terma frëngjisht u huazuan dhe integruan në anglisht, duke krijuar një trashëgimi gjuhësore që vazhdon të jetë e pranishme në anglishten moderne. Në këtë studim, janë analizuar emrat e huazuar nga frëngjishtja në fushën e administratës publike dhe juridikut, duke shqyrtuar se si dhe pse këta terma janë adoptuar dhe ruajtur në përdorim deri më sot. Metododat përfshijnë një analizë leksikore të emrave të përdorur nga shkrimtari francez Albert Kamy, meqë ky libër trajton ngjarje me karakter ligjor. Rezultatet theksojnë që në këto dy fusha janë 70 emra frëng të huazuar, si: "court", "judge", "charge", "order" dhe mbartin nuanca të rëndësishme historike dhe funksionale. Ky studim gjithashtu shqyrton se si këta terma janë modifikuar gjuhësisht dhe ruajtur kuptimet dhe përdorimet e tyre në kontekste moderne, duke reflektuar ndryshimet dhe vazhdimësitë në sistemet ligjore dhe administrative angleze dhe frënge. Ky hulumtim kontribuon në kuptimin e lidhjeve historike gjuhësore dhe ofron një perspektivë të thelluar mbi rolin e huazimeve leksikore në zhvillimin dhe funksionimin e institucioneve shoqërore dhe juridike. Përfundimet theksojnë rëndësinë e analizës së detajuar historike dhe gjuhësore për të kuptuar ndikimet afatgjata të kontakteve gjuhësore dhe kulturore.

**Fjalë kyç:** emra të huazuar, terminologji, administratë publike, l'Étranger, Albert Camus.

## Rëndësia dhe ndikimi i institucioneve paralele të viteve të 90-ta në procesin e shtet ndërtimit të Kosovës

**Burim Krasniqi**

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: [burim2.krasniqi@universitetiaab.com](mailto:burim2.krasniqi@universitetiaab.com)

### **Abstrakt**

Me anë të këtij punimi, ne synojmë të trajtojmë suprimimin e dhunshëm të autonomisë, krijimin e institucioneve paralele në Kosovë, me fokus të veçantë në arsim dhe shëndetësi. Do shtjellohet po ashtu edhe ndikimi që pati diaspora e Kosovës si në aspektin e organizimit njashtu edhe në atë të financimit të këtyre institucioneve. Në këtë punim po ashtu trajtohen edhe mendimet e personaliteteve të ndryshme për rrugën që duhet ndjekur nga populli i Kosovës për t'u çliruar nga pushteti atëhershëm serb që ushtronte dhunë vazhdimisht ndaj popullit të Kosovës.

Ky punim ndahet në tre kapituj ku në pjesën e parë trajtohet formimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës që ishte edhe epiqendra e cila çoi në krijimin e institucioneve paralele me përbërje kryesisht etnike shqiptare. Në kapitullin vijues trajtohet përjashtimi i punëtorëve shqiptarë nga institucionet shtetërore jugosllave, shembull nga arsimi, shëndetësia dhe ndërmarrjet tjera shoqërore. Në kapitullin e fundit shtjellohet në detaje organizimi si dhe funksionimi i të gjitha institucioneve paralele në Kosovë me fokus të veçantë në shtëpitë-shkolla si dhe në shtëpitë e shëndetit.

Kjo temë ka shumë rëndësi të madhe pasi duke qenë sa kanë ndodhur relativisht vonë, nuk është se janë edhe aq të trajtuara, rrjedhimisht duke marrë intervistat e akterëve të asaj kohe, ne kemi dashur t'i afrohemi sado pak të vërtetës objektive rreth atyre ngjarjeve. Intervistat e paraqitura në këtë punim nxjerrin në pah shumë detaje të cilat ende mund të mos jenë të njohura për qytetarë në kohën e sodit.

**Fjalë kyç:** institucione paralele, shtëpitë arsim, shëndetësi, Kosovë, shqiptarë

**Katalogimi në botim – (CIP)**

**Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”**

355.45(496.51)(062)

Book of Abstracts : security, Peace, and Sustainable Development in a Troubled World : international Conference / Scientific Committee Mentor Lecaj...[etj.]. - Prishtinë : Kolegji AAB, 2024. - 85 f. : ilustr. ; 30 cm.

1. Lecaj, Mentor 2. Buja, Vrullim 3. Hashani, Medain 4. Saliu, Hasan 5. Metaj-Stojanova, Albana 6. Rrahmani, Bashkim 7. Ziberi, Besime

**ISBN 978-9951-832-26-7**



ISBN 978-9951-832-26-7



9 789951 832267